



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**



*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety

---

**PLANI VJETOR I PUNËS**  
**SË BORDIT TË AKADEMISË SË KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**

10 QERSHOR 2013

## Hyrje

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Akademia ofron shërbimet e trajnimit për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- Policinë e Kosovës;
- Shërbimin Korrektues;
- Shërbimin Sprovues;
- Doganën e Kosovës;
- Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
- Inspektoratin Policor të Kosovës.

Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (më tutje i referuar si Bordi i AKSP-së) është autoritet i themeluar në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si dhe i organizuar në bazë të Rregullores nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Duke pasur një mision të qartë, Bordi i AKSP-së vendos minimumin bazë të standardeve profesionale, politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike, edukimin e specializuar dhe të avancuar të Institucioneve për siguri publike në Akademi në mënyrë që të pajisë dhe avancojë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të sigurisë publike që u shërbejnë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të qenë të sigurt në ambientet ku jetojnë dhe veprojnë.

Sfidat përballuese me dukuritë negative kërkojnë që të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit të jenë fleksibile dhe në hap me kohën, andaj Bordi i AKSP-së me qëllim të vendosjes së

standardeve ka përgatitur këtë plan vjetor në përputhje me kompetencat e Bordit të AKSP-së dhe është i ndarë në fushat kyçe të përgjegjësisë siç janë:

- Standardet minimale profesionale
- Politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike
- Politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar
- Shqyrtimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Akademisë

## **Qëllimi**

Qëllimi i këtij plani vjetor është përcaktimi i hapave kryesore të cilët i ndërmerr Bordi gjatë vitit 2013 me qëllim të kryerjes së përgjegjësisë të veta në mënyrë që nëpërmes vendosjes së standardeve dhe politikave të trajnimit dhe edukimit, pjesëtarët e institucioneve të sigurisë publike të jenë sa më të përgatitura në mënyrë profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare të pranuar, që t'u bëjnë ballë të gjitha sfidave në fushën e sigurisë publike.

Ky plan i punës paraqet prioritetet e Bordit të AKSP-së dhe jep përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e synimeve.

Duke qenë të vetëdijshëm se mund të ketë edhe zhvillime të reja, plani i punës është dokument që do të rishikohet dhe evoluojë vazhdimisht.

### **1. Standardet Minimale Profesionale**

Standardet minimale profesionale janë një sërë kriteresh të dizajnuara për të ndihmuar në matjen e përshtatshmërisë së personit për t'i shërbyer popullit të Kosovës në cilësi të Sigurisë Publike. Ajo duhet të përfshijë standardet minimale të punësimit përkitazi me etikën personale, karakterin, trajnimin dhe kompetencën e personelit të sigurisë publike dhe Akademisë.

Bordi i AKSP-së do të vendos standardet minimale profesionale në përputhje me të gjitha udhëzimet e zbatueshme të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me aftësitë dhe atributet e nevojshme për të kryer funksionet esenciale të pjesëtarit të sigurisë publike e që duhet të respektohen nga Institucionet e Sigurisë Publike.

## **2. Politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike**

Bordi i AKSP-së do të vendos politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike me qëllim të përcaktimit të programeve të trajnimeve duke identifikuar kompetencat thelbësore të nevojshme për kryerjen e kënaqshme të detyrave të pjesëtarit të sigurisë publike. Këto kompetenca duhet të përfshijnë njohuritë dhe aftësitë e identifikuara nëpërmjet analizës së detyrave të vendit të punës dhe aftësi tjera që konsistojnë në përputhje me rolin e pjesëtarit të sigurisë publike.

## **3. Politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar**

Bordi i AKSP-së do të vendos politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar duke i identifikuar fushat në të cilat edukimi i tillë është i nevojshëm. Nevojat për edukim të specializuar dhe të avancuar duhet t'i paraqesin Institucionet e sigurisë publike me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionet relevante.

## **4. Shqyrtimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Akademisë**

Akademia harton raporte periodike dhe vjetore të punës. Bordi do të shqyrtojë raportin gjashtëmuor të punës së Akademisë dhe raportin vjetor të punës.

<b><u>Detyrat e Bordit</u></b>		<b><u>Aktivitetet</u></b>		<b><u>Afati kohor - TM<sup>1</sup></u></b>	<b><u>Njësitë përgjegjëse</u></b>	<b><u>Veprimi</u></b>
1.	<b>Standardet minimale profesionale</b>	1.1	Rishikimi i standardeve minimale profesionale	TM3 – TM4	AKSP, PK, DK, AME, IPK, SHKK, SHSK	Hartimi i raportit mbi standardet ekzistuese
		1.2	Përcaktimi i standardeve minimale profesionale	TM3 – TM4	Bordi	Vendosja e standardeve minimale profesionale
2.	<b>Politikat për trajnime në fushën e sigurisë publike</b>	2.1	Rishikimi i kurikulës së trajnimeve bazike të Institucioneve të Sigurisë Publike	TM3 - TM4	AKSP, PK, DK, AME, IPK, SHKK, SHSK	Hartimi i raportit mbi gjendjen ekzistuese të trajnimeve bazike
		2.2	Përcaktimi i standardeve profesionale për trajnimet bazike për akreditimin e tyre në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve	TM4	Bordi	Caktimi i standardeve profesionale për akreditimin e tyre
		2.3	Përcaktimi i trajnimeve bazike për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës	TM4	Bordi	Vendosja për programet bazike
		2.4	Shqyrtimi i planit të trajnimeve të Akademisë	TM4	AKSP, PK, DK, AME, IPK, SHKK, SHSK	Hartimi i planit të trajnimeve
3.	<b>Politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar të institucioneve të sigurisë publike</b>	3.1	Identifikimi dhe analiza e nevojave për trajnime të specializuara dhe të avancuara	TM 4	AKSP, PK, DK, AME, IPK, SHKK, SHSK	Rishikimi i analizave të nevojave për trajnime të ndryshme – të reja
		3.2	Krijimi i sistemit të trajnimeve të përbashkëta të standardizuara për Institucionet e Sigurisë Publike	TM4	Bordi	Programet trajnuese të rishikuar, hartuar dhe miratuar
		3.3	Rishikimi, avancimi dhe përpilimi i moduleve të reja për trajnime të specializuara dhe të avancuara	TM4	AKSP, PK, DK, AME, IPK, SHKK, SHSK	Rishikimi dhe propozimi për module për trajnime të ndryshme – të reja
4.	<b>Shqyrtimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Akademisë</b>	4.1	Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të Akademisë	TM3	AKSP	Hartimi i raportit gjashtëmujor

<sup>1</sup> TM – nënkupton afatet kohore të ndara në periudha Tre Mujore.